

VENDIM
Nr. 411 , datë 10.5.2017

**PËR DERDHJEN E KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE
NJOHJEN SI PERIUDHË SIGURIMI TË PERIUDHËS KUR BASHKËSHORTI/JA KA
SHOQËRUAR PERSONELIN E SHËRBIMIT TË JASHTËM NË MISIONIN
DIPLOMATIK OSE POSTIN KONSULLOR JASHTË SHTETIT**

Në mbështetje të neneve 52, pika 1, 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, të neneve 9 e 58, pika 2, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 54, të ligjit nr.23/2015, “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Punëve të Jashtme, në bazë të listës së bashkëshortëve që kanë shoqëruar personelin e shërbimit të jashtëm në misionet diplomatike ose postet konsullore të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja, të bëjë pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore të paderdhura, si më poshtë vijon:

a) Për periudhën 1 janar 1998 deri më 31 dhjetor 2015, pagesa të mbulohet me kontribute vetëm nga dega e pensioneve, ndërsa për periudhën 1 janar 2016 deri më 31 dhjetor 2016 pagesa të mbulohet me kontribute të të gjitha degëve të sigurimit shoqëror, bazuar në normën e kontributit sipas degëve të sigurimit, të përcaktuar në dispozitat e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b) Masa e kontributit të sigurimeve shoqërore për personat përfitues, për periudhën 1 janar 1998 deri më 31 dhjetor 2015, të llogaritet në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në fuqi për vitin 2016, ndërsa për periudhën 1 janar 2016 deri më 31 dhjetor 2016, bazuar në pagën që përfituesi kishte përpara ndërprerjes së punës. Në rastet kur përfituesi nuk ka qenë i punësuar, kontributet e sigurimeve shoqërore llogariten bazuar në pagën minimale në shkallë vendi në fuqi për vitin 2016.

c) Pagesa e kontributeve të bëhet drejtpërdrejt për llogari të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Mënyra e pagesës së kontributeve, llogaritë bankare ku do të kryhen transfertat dhe dokumentacioni që pasqyron kontributet individuale caktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Lista e personave që përfitojnë këtë trajtim, sipas viteve, do të jetë pjesë e udhëzimit dhe do të arkivohet në arkivat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

2. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, në bazë të listë-pagesave të paraqitura nga Ministria e Punëve të Jashtme, të bëjë njohjen e periudhave të paguara sipas pikës 1, të këtij vendimi, si periudhë sigurimi për bashkëshortin e personelit të shërbimit të jashtëm.

3. Për efekt të këtij vendimi, bashkëshort i personelit të shërbimit të jashtëm, janë:

a) bashkëshorti/ja që ka shoqëruar personelin diplomatik në misionet diplomatike ose postet konsullore të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja;

b) bashkëshorti/ja që ka shoqëruar personelin administrativo-teknik në misionet diplomatike ose postet konsullore të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja, pa përfshirë personelin teknik vendas.

4. Fondi financiar për pagesën e kontributit të sigurimeve shoqërore të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme që do të miratohet për vitin 2018.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi